



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALESE - IZLAZNA

Nr/Br 01-190
Me/Dana. 08.04.2019

NOVOBRDË - NOVOSRBO



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e katërt të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **16.04.2019** (e martë) duke filluar në orën **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rreth barazis gjinore në Komunë;
3. Diskutim rreth emërtimit të rrugëve në fshatrat e Komunes;
4. Diskutim rreth mundësisë për ndjekjen e kurseve të gjuhës shqipe dhe serbenga ana e shërvbyesve civil;
5. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve;
6. Të ndryshme;

Me: 08.04.2019
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 22.03.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Abdyl Gashi, Behare Jashari, Nënkyetari Komunës Sinisa Dimic, Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri, zv.Kryesuesi i Kuvendit Ramush Mehmeti, ZKKK Jasmina Denic, Zytari i Bujqësis Avdi Vllasaliu dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendetë të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Aprovimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete;
3. Gjendja e sigurisë ne Komunën e Novoberdes;
4. Subvencionimi në Bujqësi, procedurat e aplikimit;
5. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend ditë? Pasi nuk pat diskutime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Aleksander Pavic pasi përshendetë të pranishmit tha: në mbledhjen e kaluar kam qenë prezen, por procesverbali më ka ardh dy faqe në gjuhen shqipe ndërsa dy në gjuhen serbe nuk e di a është ndonjë gabim teknik.

Kryesuesja tha: sigurisht është ndonjë gabim teknik.

Pasi nuk pat diskutime tjera procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët prezent.

Pika e dytë: Aprovimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete;

Kryesuesja tha: planin e punës e keni marrë më ftese në të cilin kemi punuar bashkarisht në takimin që patem të restaurant Lura në bashkpunim me OSBE-n, nese keni me plotësu diçka para aprovimit mund të propozoni.

Abdyl Gashi pasi përshendetë të pranishmit tha: në propozimet të cilat i kemi pasur i propozum në takim pune, diksutime qe i kemi bërë e kam parë se janë futur në plan, është një plan i mirë ku do ti kemi për çdo mujë pikat që do të diskutojmë, normal është një plan udhërrefyes për ne por nuk do të thot se ne në të ardhmen nuk do të mundë të ndryshojm diçka apo të shtojm diçka.

Kryesuesja tha: po mundë të ndryshojm ndonjë pikë, varësishtë prej kerkesave.

Pasi nuk pat diskutime plani i punës për komitete për vitin 2019 u aprovua njëzëri nga antarët prezent.

Pika e tretë: Gjendja e sigurisë ne Komunën e Novoberdes;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: bashkarisht e kemi diskutu dhe e kemi pa të rëndësishme që me diskutu për sigurin në Komunë dhe në këtë takim të jet edhe dikush nga policia që të na informoj por perderisa nuk janë prezent propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe nga Kryesuesja të njoftohet Komandanti nga stacioni policor.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendetë të pranishmit tha: e kam një vërejtje pse nuk është askush nga stacioni policor, pasi në restaurant Lura kemi kërkuar që prioritet të jetë kjo pikë dhe të njoftohen dikush nga policia që të janë prezent në mbledhje, andaj kërkoi sqarim nga Kryesuesja se a i keni njoftuar apo jo policin.

Kryesuesja tha: jo nuk i kemi njoftuar, por në mbledhjen e ardhshme do ti ftojm.

Aleksander Pavic tha: pajtohem me diskutimin e kolegut që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe të njoftohet komandanti i policisë.

Lutfi Hoxha përfaqësuesi i OSBE-së tha: sju ndalohet të diskutoni, ju mundë të diskutoni dhe në fund të keni ndonjë rekomandim.

Aleksander Pavic tha: pajtohem me këtë që tha përfaqësuesi i OSBE-së por mendoj se organi që është i thirrur për siguri të jetë këtu prezent dhe të na njoftoj.

Abdyl Gashi tha: po nderlidhem me propozimin e Kryetarit të Komunës i cili e ka propozuar një list për formimin e KKSBB-ës, një list e cila përfaqëson më shumë militant partish dhe mendoj se së pari është duhur që kjo list të vij në Komitet për Komunitete.

Dobrivoje Djordjevic tha: unë atë list nuk e kam parë, nuk e di se për kënd bëhet fjalë dhe nuk mundë ta komentoj, që disa herë po e perserit se po diskutojm për gjëra të rëndësishme por në fund nuk po vendosim asgjë, prej fillimit po kërkojm që të vjen dikush nga egzekutivi dhe të diskutojmë, pasi që nënkyrjetarët janë prezent mundë të na dhëjnë ndonjë informatë.

Sinisa Dimic pasi përshendetë të pranishmit tha: sa i përket lsites që u përmend është vetem listë e propozuar, do të diskutojm në Kuvend për emrat, aty shkruan se është propozim i cili është dhënë në bazë të udhëzimit administrativ se kush ka të drejt të jetë antarë i këtij komitetit, cilat janë kriteriumet të cilat duhet ti plotësoj dhe ky është vetem propozim. U përmend edhe qështja e siguris më herët, tju njoftoj se kemi kontakte të rregullta me komandantin e policisë, rastet e fundit i ka marrë njësia regionale e policis në Gjilan, i vetmi probem që e kemi dhe që po bartet nga viti në vit janë vjedhjet, andaj nuk mundë të jemi të knaqur me punen e policisë, sa i përket problemve nderetnikë ne fatmirësishtë nuk kemi, dhe mundë të them se mardhenjet ndëretnikë janë në nivel të knaqëshëm, përsëri po e permendi se ne duhet ta ndihmojm punën e policisë në mënyrë që të janë më të suksesëshem në punën e tyre, kështu që shpresoj se ne të gjithë së bashku do tju ndihmojmë në punën e tyre.

Abdyl Gashi tha: në njëren prej maledhjeve parafolsi na pat njoftuar se policia do të kaloj prej një kategorie në kategorin tjeter ku policia do të ketë fuqi më të madhe si në rritje të numrit të policëve, a ka përfudnuar kjo?

Sinisa Dimic tha: ne e kemi pregaditur dhe derguar kërkesen tonë në MAPL dhe Kryeministrit të Qeverisë, jo zyrtarisht na kanë njoftuar se kjo qështje do të zgjidhet në mënyrë pozitive dhe policia do të kaloj nga kategoria C në kategorin B, mirëpo fatkeqështë ende zyrtarisht nuk kemi marrë asnjë përgjegjje, shpresoj se do të marrim ndonjë përgjegjje në afat sa më të shkurt dhe ne si Komunë do tju dalim në ndihmi dhe do ti perkrahim në qfarë do mënyre.

Ramush Mehmeti pasi përshendetë të pranishmit tha: po ja parashtroj një pyetje nënkyetarit pasi që në Kuvend ka ardh një kërkesë nga stacioni policor për ndarjen e një parcele për ndertim të stacionit të ri policor, Kuvendi Komunal ka kerkuar që të dihet se ku është ajo parcel pasi që nuk mundë të ndahet paushall, andaj mendoj se Komuna duhet ta bij propozimin ku do të thot se në këtë parcel kjo zonë katastrale do të ndahet për ndertimin e stacionit policor dhe ne si Kuvend normalisht se do ta aprovojmë.

Sinisa Dimic tha: edhe policia i ka kriteret e veta dhe i kan organet e veta ku do të vendosin se ku do të ndërtohet, ende se kanë caktuar se ku do ta ndertojnë edhe ose i kanë disa lokacione si ide, kur ata do të na jepin neve një informat se ku do ta ndertojnë pra atyre ku ju pershatet ndertimi i objektit, atëher ne do tju dhëjmë juve informata sipas kërkesës së tyre.

Abdyl Gashi tha: a ka menduar ndonjëher Kryetari së bashku me ekipin e tij që të vendos kamera në udhëkryqet e Komunës, për arsy se policia dhe Komuna janë dy organe të lidhura mes veti.

Sinisa Dimic tha: supozojm se kemi të gjithë të njëjtën përgjegjësi dhe të gjitha jemi të obliguar që ti ndihmojmë në punë policisë dhe për ti realizuar disa projekte na duhen mjete financiare, i kemi në plan që udhëkryqet ti mbulojm me kamera ose me ndriqim që tja lehtësojm punën policëve dhe në momentin që do të kemi kushte financiare do ta realizojm këtë gjë.

Abdyl Gashi tha: për këtë arsy pasi që e kemi obligim që tju ndihmojmë policive në punen e tyre andaj mendoj pasi që edhe jeni në qeverisje së bashku me LDK e keni një pjesë të fajit për arsy se Komuna ka mundësi të bëjë një menaxhim më të mirë, nuk është turp me lanë një rrugë keq e me vendos kamera në udhëkryqe dhe nuk është një projekt i cili kushton milona euro.

Sinisa Dimic tha: e thash më herët po e perseris prap se në momentin që do të kemi mundësi financiare do ta realizojmë këtë.

Abdyl Gashi tha: mundësit financiare i krijon qeverisja dhe nese është një qeverisje e aftë për qeverisje të vendit, atëher i shikon së pari prioritetet.

Sinisa Dimic tha: është përgjegjësi e jona por në anen tjeter Kuvendi ka aprovuar prioritetet, dhe të kemi besim dhe bashkëpunim me policin.

Abdyl Gashi tha: e kam edhe një pyetje lidhur me rrugen te tregu në Llابjan a keni menduar ndonjëher të merrni masa pasi që shëtit aty janë të rrezikuar, aty nuk ka kushte as për treg dhe është rrezik përhapja e ndonjë epidemie pasi që në fund nuk pastrohet.

Sinisa Dimic tha: nese dikush është ankuar në Drejtori të Inspeksionit besoj se inspeksioni ka dal në teren.

Abdyl Gashi tha: nuk do të thot vetem ankesa të kemi, syta janë me pa dhe Komuna duhet të krijoj kushte më të përshtatshme për ata tregtarë, dhe nese kemi ndonjë rast në ambulant aty duhet te pres gjys ore që të kaloj.

Sinisa Dimic tha: është detyrë e policis që ta mbajn rrugen e hapur.

Abdyl Gashi tha: kush është ndertuar tregu është duhur të mendohet edhe parkingu.

Dobrivoje Djordjevic tha: pajtohem me vendosjen e kamerave dhe nese Komuna vjen me një plan të mirë që të vendosen kamerat në udhëkryqet e pashmangshme, Kuvendi do ta aprovoj atë plan, normal duhet në bashkpunim me policin, sa i perket tregun në Llabjan pasi që kam qenë polic në Novobërdë dhe e di problemin e tregut dhe policia i ka denuar shkelsit e rendit

Pika e katërt: Subvencionimi në Bujqësi, procedurat e aplikimit;

Kryesusja për këtë pikë ja dha fjalen Zyratrit për Bujqësi Avdi Vllasaliu.

Avdi Vllasaliu pasi përvendetë të pranishmit tha: sa i perket Drejtorisë së Bujqësisë janë të regjistruar 1138 fermer, fermer egzistues janë 390, fermer gjysëmkomercial janë 455 dhe fermer komercial janë 293. Sa i përkthet mënyres së aplikimit të subvencionimit i kemi dy mënyra prej Ministrisë së Bujqësisë dhe prej Komunës. Mënyra e aplikimit për subvencione në MB është nese aplikon për drithat e bardha, kriteri është që fermeri duhet ti ketë 2 ha grur, eplb 1ha, miser 1ha, theker 1ha, nese eshte me mjeder apo malin është prej 10ari, ndërsa më lop të drejten e aplikimit e kan me 5 lop qumështore, dele 30, dhi 20, blet, 30 koshere, Fermeri për të pasur të drejt aplikimi duhet me qenë i regjistruar në Drejtorin. Subvencione nga Komuna Drejtoria e Bujqësisë i vendos kriteret varësisht se për çfarë subvencione bëhet fjalë. Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: po e shprehi një shqetësim të cilin e kanë qytetarët më shumë sa i përkthet subvencioneve në bujqësi është informacioni i paktë që e kanë lidhur me aplikimin dhe lajmrimet të cilat vendosen përveq eebfaqes, ata të cilët janë të njoftuar më shumë janë punëtorët e Komunës, të cilët punojnë në Komunë dhe aplikojnë e normalisht shumica prej tyre perfitojnë pasi që i kanë lidhjet me Kryetarin e Komunës, mendoj se Drejtoria e Bujqësisë duhet ét jetë një shembull se si tju ndihmohet bujqëve pasi që afer 70% e banorëve të Komunës jetojn nga bujqësia.

Bajrush Ymeri pasi pershendetë të pranishmit tha: faleminderit për prezantimin, gjithqka ishte e qartë për mu dhe besoj për të gjithë antarët e komitetit dhe antarët e kanë mundësin që tash ti njoftojnë edhe qytetarët për këto procedura, nuk e di a e permendet por me intereson të dij afati kohor kur është në MB?.

Avdi Vllasaliu tha: afati kohore ne MB ka qenë me 15 shkurt kemi filluar dhe me 15 prill ka përfunduar, por këtë vit nuk është hapur ende aplikimi, sa i perket lajmerimeve ne i vendosim në çdo fshat.

Dobrivoje Djordjevic tha: sa i perket këtyre subvencioneve nuk mendoj se kreiter duhet me qenë 2 ha tok te punuar pasi që ka bujqë që punujn nën 2 ha dhe nuk perfitojnë asgjë.

Avdi Vllasaliu tha: kriteret nuk varen nga ne as nga Komuna por i vendos MB.

Bajrush Ymeri tha: e kuptove se këto subvencione ipen nga MB dhe kriteret percaktohen prej tyre, e dyta se këto janë subvencione për me stimulu ngritjen e bujqësisë në teritorin e Kosovës, aj fermer kur i mbjell 2ha grur dhe i merr 300€ ai mbjell edhe 1ha, me nxit atë me mbjell më tepër.

Aleksander Pavic tha: e kam një pyetje nese një zyratë në departament të bujqësisë në Komuna aplikon në subvencione ne MB a është konflikt interesit?

Avdi Vllasaliu tha: jo sepse punon edhe me bujqësi dhe është i regjistruar si fermer.

Aleksander Pavic tha: e bëra këtë pyetje sepse një disa organizata që dhënë donacione të punësuarit në ato organizaçata nuk kanë të drejt të aplikojnë.

Pika e pestë: Të ndryshme;

Kryesuesja tha: ja dha fjalën zyrtares së ZKKK Jasmina Denic nese ka diçka të na raportoj nga muaji i fundit.

Jasmina Denic pasi përshtendeti të pranishmit tha: prej muajit të kaluar kemi punuar në këto aktivitete, ju kam njoftuar në muajin e kaluar se është pruar një rregullore e re dhe kemi pasur takim lidhur me projektin DRK5 rrëth qështjes së kthimit, qëllimi i këtij takim ka qenë që të njoftohen antarët e këtij komiteti për mënyren dhe formen e punës tanë e tutje, gjatë muajit të kaluar kemi pasur edhe aprovimin e rasteve të para nga ana e komisionit Komunal për kthim, projekti për ndihmen e familjeve të të kthyerë dhe ne renovim të shtepive, janë aprovuar 3 raste, 1 për konstruktum dhe 2 për paketen e harmonizimit. Projekti për harmonizim është mobile, teknik e bardhë dhe vetfinancim. Kemi pasur vizita në terren për ndertimin e shtepive të reja, kemi punuar me Drejtorin e Urabnaizimit që të ipen leje për ndertimin e katër shtepive që po i financion Ministria e kthimit, të riatdhezuarit 3 vjet janë ndihmuar në pregaditjen e biznes planit, ato plane i kanë derguar në qendren për punësim ndërsa zyratri për riatdheshim i ka ndihmuar në pregaditjen e këtyre biznes planeve, kemi pasur takim me ju dhe OSBE-n për pregaditjen e këtij planit të punës së Komitetit, dje kemi pasur edhe një takim me grupin e grave të Novobërdës permes UNDP ku kanë qenë të ftuar edhe antret e Kuvendit dhe Komitetit, me vjen keq që nuk janë përgjigjur pozitivisht kësaj ftesë por ju njoftoj se grupa e grave ka punuar në perzgjedhje te prioriteteve te cilat janë: blerja e një ultrazëri mobil, kontolla gjinekologjike 1 herë ne muaj dhe mbrojtja shendetore 24h.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:20

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

